



# **Anketë për njohuritë, qëndrimet dhe praktikat e të rinjve lidhur me trafikimin e qenieve njerëzore në katër qarqe të Shqipërisë**

---

**Vala e dytë**

**Përmbledhje e gjetjeve për Romët**

SHTATOR 2022

**Autorë:** [Deanna Davy](#), Konsulente ndërkombëtare për UNICEF Shqipëri  
[Blerina Metanj](#), IDRA Shqipëri

**Drejtues i Studimit:** [Elda Denaj](#), Specialistja e Monitorimit të të Drejtave të Fëmijëve dhe Vlerësimit në UNICEF Shqipëri

**Editor:** [Iain Wilson](#)

Ky dokument është përgatitur në kuadër të programit *Transformimi i Përgjigjes Kombëtare ndaj Trafikimit të Qenieve Njerëzore në dhe nga Shqipëria*, zbatuar nga një koalicion i gjashtë organizatave ndërkombëtare dhe kombëtare: UNICEF Shqipëri, Organizata për Siguri dhe Bashkëpunim në Evropë/Prezenca në Shqipëri, Terre des Hommes, Tjetër Vizion, Vatra dhe Të Ndryshëm dhe të Barabartë. Programi financohet nga qeveria e Mbretërisë së Bashkuar (MB).

Pikëpamjet e shprehura në raport nuk pasqyrojnë domosdoshmërisht qëndrimet zyrtare të UNICEF-it ose të pozicioneve të zyrtarëve të qeverisë së Mbretërisë së Bashkuar.

Lexuesit inkurajohen të përdorin materiale nga ky raport për botimet e tyre. Si mbajtës i së drejtës së autorit, UNICEF-i në Shqipëri kërkon përmendjen e duhur dhe një kopje të botimit.

**Citim i sugjeruar i raportit:**

Davy, D., dhe Metanji, B. (2022) “Anketë për njohuritë, qëndrimet dhe praktikatat e të rinjve lidhur me trafikimin e qenieve njerëzore në katër qarqe të Shqipërisë: Vala e dytë. Përmbledhje e gjetjeve për Romët” UNICEF-I Shqipëri dhe IDRA.

Për komente dhe sugjerime ju lutem shkruani në adresën elektronike [tirana@unicef.org](mailto:tirana@unicef.org)

# **Anketë për njohuritë, qëndrimet dhe praktikat e të rinjve lidhur me trafikimin e qenieve njerëzore në katër qarqe të Shqipërisë**

**Vala e dytë**

Përmbledhje e gjetjeve për Romët

Shtator 2022



## TABELA E PËRMBAJTJES

|                                 |    |
|---------------------------------|----|
| 1. HYRJE .....                  | 4  |
| 2. QËLLIMI DHE OBJEKTIVAT ..... | 5  |
| 3. METODOLOGJIA.....            | 6  |
| 4. GJETJE .....                 | 8  |
| 5. PËRFUNDIME .....             | 20 |

# 1. HYRJE

Shqipëria është prekur ndjeshëm nga trafikimi i qenieve njerëzore dhe vazhdon të zhvillojë një sërë politikash dhe mekanizmash për ta luftuar këtë fenomen. Vendi njihet si vendburim për trafikimin e qenieve njerëzore. Shqiptarët trafikohen shpesh drejt Italisë, Greqisë, Mbretërisë së Bashkuar, Suedisë, Gjermanisë dhe Zvicrës nëpërmjet rrjeteve të organizuara kriminale. Ndërkohë, trafikimi brenda vendit vijon të jetë një fenomen i konsiderueshëm prej rreth dy dekadash, shumica e viktimave vendase të të cilit janë fëmijë dhe të rinj. Shumë viktime shqiptare vijnë nga familje të varfra, janë të papunë dhe me mangësi në arsimim. Për fëmijët dhe të rinjtë e trafikuar, faktorët e riskut e kanë zanafillën kryesisht te situatat familjare, dhe përfshijnë braktisjen ose shpërbërjen e familjes. Pasoja e këtyre faktorëve është fakti që atyre iu mungojnë rrjetet e rëndësishme të sigurisë dhe mbrojtjes.

Pavarësisht të dhënave të qarta se të rinjtë shqiptarë janë të cenueshëm nga trafikimi i qenieve njerëzore, ka mungesë literature për nivelin e njohurive të tyre për këtë fenomen brenda vendit, ose për qëndrimet dhe praktikatat e tyre lidhur me të. Vetëm një studim i fundit (2016) trajton njohuritë dhe ndërgjegjësimin për trafikimin e qenieve njerëzore në Shqipëri.<sup>1</sup> Nga ai studim, kuptojmë se të rriturit shqiptarë janë më të ndërgjegjshëm rreth trafikimit për qëllime seksuale sesa rreth trafikimit për qëllime pune; më shumë se gjysma e të rriturve shqiptarë të anketuar mendojnë se trafikimi i qenieve njerëzore është problem serioz, por prek kryesisht gratë dhe fëmijët; dhe se shumë persona nuk dinë se si mund t'i ndihmojnë viktimat e mundshme.

Duke qenë se ai studim nuk trajtoi posaçërisht nivelin e njohurive të të rinjve, ose qëndrimet dhe praktikatat e tyre lidhur me trafikimin e qenieve njerëzore, studimi aktual e shqyrton këtë çështje me qëllim plotësimin e mangësive të rëndësishme në njohuri. Rezultatet e studimit do të jenë të dobishme për qeverinë dhe palët joqeveritare të interesit që punojnë në fushën e parandalimit të trafikimit të qenieve njerëzore.

Studimi aktual është një anketë e valës së dytë për njohuritë, qëndrimet dhe praktikatat e të rinjve shqiptarë lidhur me trafikimin e qenieve njerëzore në katër qarqe të vendit, dhe te romët. Kjo anketë pason atë të valës së parë, rezultatet e së cilës u publikuan në dhjetor të vitit 2020.<sup>2</sup> Kjo anketë e valës së dytë përsërit pyetjet e valës së parë.

Ky raport përqendrohet te të rinjtë romë, duke krahasuar rezultatet e anketës për ta me ato të popullsisë së përgjithshme të studimit në katër qarqe. Për analizë të mëtejshme, të dhënat e mbledhura nga anketa e valës së dytë mbahen dhe vizualizohen në një panel të posaçëm.<sup>3</sup>

Krahasimi këtu nuk bëhet ndërmjet rezultateve të anketës së valës së parë dhe të valës së dytë pasi ndryshimet në njohuri, qëndrime dhe praktika janë minimale. Duhet theksuar se aty ku nuk trajtohen të dhënat në tabela dhe shifrat, kjo ka të bëjë me faktin se ndryshimet janë të papërfillshme.

---

<sup>1</sup> USAID, 2016, Matja e opinionit publik lidhur me trafikimin e qenieve njerëzore në Moldavi dhe Shqipëri duke përdorur anketa eksperimentuese për të informuar programet efektive të parandalimit dhe ndërgjegjësimin.

<sup>2</sup> Davy, D., dhe Metanji, B., 2020, [Anketë e valës së parë mbi njohuritë, qëndrimet dhe praktikatat e të rinjve lidhur me trafikimin e qenieve njerëzore në katër qarqe të Shqipërisë. Raport për gjetjet](#). Qeveria e Mbretërisë së Bashkuar, IDRA, UNICEF në Shqipëri:

<sup>3</sup> [Paneli i studimit](#)

## 2. QËLLIMI DHE OBJEKTIVAT

Nëpërmjet këtij studimi synohet të kuptohet dhe eksplorohet niveli i njohurive, qëndrimeve dhe praktikave të rinjve lidhur me trafikimin e qenieve njerëzore në qarqet Dibër, Kukës, Shkodër dhe Tiranë, si dhe te të rinjtë romë.

Objektivat e studimit ishin krahasimi i diferencave në nivelet e njohurive, qëndrimeve dhe praktikave të rinjve të anketuar në katër qarqe:

### Njohuritë

- Ku ndodh trafikimi i qenieve njerëzore
- Format e shfrytëzimit që ndodhin në Shqipëri dhe në vende të huaja
- Kush është në risk nga trafikimi i qenieve njerëzore
- Metodatat e rekrutimit dhe trafikantët e qenieve njerëzore
- Mënyrat për të raportuar rastet e dyshuara të trafikimit të qenieve njerëzore
- Shërbimet mbështetëse të disponueshme për viktimat

### Qëndrimet

- Niveli i shqetësimit lidhur me trafikimin e qenieve njerëzore
- Qëndrimet ndaj viktimave

### Praktikat

- Interesi për të mësuar rreth trafikimit të qenieve njerëzore
- Interesi për t'u përfshirë në aktivitetet e parandalimit dhe mbrojtjes nga trafikimi i qenieve njerëzore

### 2.1 Rezultatet e komunikimeve të UNICEF-it

- Ekspozimi ndaj materialeve për komunikim mbi trafikimin e qenieve njerëzore gjatë dy viteve
- Rritja e njohurive, qëndrimeve dhe interesit për t'u angazhuar në aktivitete kundër trafikimit të qenieve njerëzore si rrjedhojë e ekspozimit.

### 2.2 Struktura e raportit

Pas këtij seksioni hyrës, raporti paraqet metodologjinë e studimit, e pasuar nga gjetjet mbi njohuritë, qëndrimet dhe praktikatat e të rinjve romë lidhur me trafikimin e qenieve njerëzore. Raporti mbyllet me një përmbledhje të shkurtër të pikave kryesore.

---

<sup>4</sup> Grupmosha 15–29 vjeç, siç përcaktohet nga Komisioni Evropian. Shihni [EUROSTAT, Të rinjtë - Vështrim i përgjithshëm](#).

## 3. METODOLOGJIA

### 3.1 Qasja ndaj anketës

Për studimin aktual janë anketuar rreth 1,600 të rinj (Tabela 1), duke përfshirë të anketuar të grupmoshës 15-29 vjeç që jetojnë në Dibër, Kukës, Shkodër dhe Tiranë (350 të anketuar në secilin qark). Kampioni përfshiu edhe një kampion plotësues prej 200 të rinjsh të popullatës rome që jetojnë në Kukës, Shkodër dhe Tiranë. Gjetjet e anketës për grupin e fundit paraqiten në këtë raport. Kampioni i popullatës rome konsiderohet kampion plotësues në anketë pasi përzgjedhja e tyre nuk u krye sipas një procedure rastësore. Arsyeja për këtë qasje është se romët përbëjnë vetëm 0.3 për qind të popullsisë së përgjithshme banuese në vend.<sup>5</sup>

Kjo shifër e ulët do ta kishte bërë përzgjedhjen rastësore të të rinjve romë pjesëmarrës në anketë shumë sfiduese. Për rrjedhojë, popullata e të rinjve romë të anketuar u kontaktuan në zona të identifikuar si të banuara nga ky grup i synuar. Rreth 19 për qind e të rinjve romë të anketuar u anketuan në Kukës, 25 për qind në Shkodër, dhe 56 për qind në Tiranë.

Rezultatet për të rinjtë romë nuk janë përfaqësuese të të gjithë popullatës rome që jeton në vend. Megjithatë, 200 të anketuar të tillë është një numër tregues që jep informacione të rëndësishme rreth njohurive, qëndrimeve dhe praktikave të të rinjve romë lidhur me trafikimin e qenieve njerëzore. Anketa u zhvillua nëpërmjet intervistave ballë-për-ballë. Vetëm një person për familje, i grupmoshës 15-29, u ftua të merrte pjesë. Përzgjedhja në mënyrë rastësore e familjeve u bë nëpërmjet një softueri. Mbledhja e të dhënave u krye gjatë periudhës 14 janar deri në 1 mars 2022 nga intervistues të trajnuar të IDRA Research & Consulting. Çdo intervistë zgjati rreth 20 minuta.

### 3.2 Analiza e të dhënave

Analiza e të dhënave u krye nga IDRA duke përdorur paketën softuerike të të dhënave statistikore IBM SPSS 25. Të dhënat u ponderuan për të qenë përfaqësuese për secilin qark dhe në tërësi. Kjo u bë në mënyrë që kontributi i të anketuarve nga secili qark të ishte proporcional me shifrat e popullsisë së qarkut. Rezultatet u ndanë sipas treguesve demografikë kryesorë, si gjinia dhe mosha.

### 3.3 Konsiderata etike

Anketa për trafikimin e qenieve njerëzore nuk përmbante pyetje të vështira ose të ndjeshme për të rinjtë. Megjithatë, u krye një vlerësim i etikës, pasi të dhënat u mbledhën nga fëmijë të grupmoshës 15-17 vjeç dhe më të rritur (18-29 vjeç). Përpara fillimit të mbledhjes së të dhënave, studimi mori miratimin etik nga Health Media Lab. Ltd. Bordi i Rishikimit të Etikës.<sup>6</sup>

Për këtë studim, ekipi respektoi sa më poshtë:

- Rregulloren “Për Etikën në Veprimtarinë Kërkimore dhe Botuese”, dhe, në veçanti, nenin 1.1.4, që u kërkon institucioneve “të ruajnë një klimë bashkëpunimi që nxit përgjegjshmëri dhe etikë në kërkim”. Ky udhëzim (rregullore) u nxor nga Qeveria e Shqipërisë për të orientuar çështjet e lidhura me etikën për shoqëritë, institucionet dhe konsulentët që kryejnë punë kërkimore.
- Procedurat e UNICEF-it për Standardet Etike në Kërkim, Vlerësim, Mbledhje dhe Analizë të Dhënash (2021).

Ekipi i kërkimit respektoi standardet e mëposhtme themelore:

- subjektet nuk vihen në risk të tepruar;

<sup>5</sup> Instituti i Statistikave i Shqipërisë: [Rezultate të Censurit 2011](#); Linku, aksesuar për herë të fundit në gusht 2022:

<sup>6</sup> Shihni <https://www.healthmedialabirb.com/>

Tabela .1. Numri i intervistave të anketës të kryera në secilin qark të synuar dhe me romët

| Qarku                               | Nr.          |
|-------------------------------------|--------------|
| Tiranë                              | 350          |
| Shkodër                             | 350          |
| Kukës                               | 341          |
| Dibër                               | 346          |
| <b>Totali, 4 qarqe</b>              | <b>1,387</b> |
| Rom/e                               | 200          |
| <b>Totali i të anketuarve (Nr.)</b> | <b>1,587</b> |



- pjesëmarrja është vullnetare, dhe subjektet informohen dhe u sigurohet një formë pëlqimi, me të cilën duhet të bien dakord paraprakisht; dhe
- ekzistojnë protokollet me shkrim për të siguruar konfidencialitetin dhe anonimitetin.

Gjatë mbledhjes së të dhënave, intervistuesit ndanë fletëpalosje me pjesëmarrësit në anketë dhe familjet e tyre, duke përfshirë informacion për shërbimet mbështetëse për kujdesin mendor dhe psikologjik, dhe kanalet e raportimit për trafikimin e qenieve njerëzore.

## 4. GJETJE

### 4.1 Profili i të rinjve romë të anketuar

Nga 200 të rinj romë të anketuar, 46 për qind ishin femra dhe 54 për qind ishin meshkuj (Figura 1). Shumica e të rinjve romë të anketuar (45%) ishin të grupmoshës 18–24 vjeç, 31 për qind të grupmoshës 15–17 vjeç, dhe 25 për qind të grupmoshës 25–29 vjeç (Figura 2).

Figura 1. Të anketuarit sipas seksit





Figura 2. Plotësuesit e anketës sipas grupmoshës.




### 4.2 Njohuritë rreth trafikimit të qenieve njerëzore

#### Ku ndodh trafikimi i qenieve njerëzore

Të dhënat e anketës tregojnë se shumica e të rinjve romë e dinë se trafikimi i shtetasve shqiptarë ndodh në vende të huaja (Figura 3). Megjithatë, të rinjtë romë kanë më pak njohuri se trafikimi ndodh brenda Shqipërisë dhe edhe më pak prej tyre dinë që ndodh në komunitetin ose zonën e tyre.

**Të rinjtë romë kanë njohuri më të mira se ku ndodh trafikimi i qenieve njerëzore sesa popullsia e përgjithshme në katër qarqet e anketuara.** Gjashtëdhjetë e një për qind e të rinjve romë të anketuar mendojnë se trafikimi i shtetasve shqiptarë në vende të huaja ndodh në masë shumë të madhe ose të madhe, krahasuar me 51 për qind të popullsisë së anketuar në katër qarqe. Ndërkohë, 51 qind e të rinjve romë mendojnë se trafikimi i qenieve njerëzore ndodh brenda vendit në masë shumë të madhe ose të madhe, krahasuar me 40 për qind të popullsisë së anketuar në katër qarqe. **Tridhjetë e tre për qind të të rinjve romë të anketuar kanë njohuri se trafikimi ndodh në komunitetin ose zonën e tyre, krahasuar me vetëm dhjetë për qind të popullsisë së përgjithshme të anketuar në katër qarqe.**


Figura 3. Njohuri për ndodhshmërinë e trafikimit të shtetasve shqiptarë



**Pyetje ankete:** Në dijeninë tuaj, në ç'masë ndodh trafikimi i qenieve njerëzore (shtetasve shqiptarë) në vende të huaja, në Shqipëri dhe në komunitetin ose zonën tuaj? Grafiku paraqet vetëm përqindjet për alternativat e përgjigjeve “në masë shumë të madhe” dhe “në masë të madhe”. **Popullata e synuar:** Romët, në total katër qarqe

**Te të rinjtë romë, më shumë femra sesa meshkuj kanë njohuri se trafikimi i qenieve njerëzore ndodh (Figura 4) në Shqipëri, përkatësisht 59 për qind dhe 44 për qind.**


Figura 4. Njohuri për ndodhshmërinë e trafikimit të shtetasve shqiptarë, sipas seksit



Grafiku paraqet vetëm përqindjet për alternativat e përgjigjeve “në masë shumë të madhe” dhe “në masë të madhe”. **Popullata e synuar:** Romët

Në përgjithësi, rezultatet sipas grupmoshës tregojnë se të rinjtë romë të grupmoshës 25-29 vjeç kanë njohuri për ndodhinë e trafikimit të qenieve njerëzore krahasuar me grupmoshën e më të rinjve (Figura 5). Dyzet e një për qind e të rinjve romë të anketuar të grupmoshës 25–29 vjeç kanë njohuri se trafikimi i qenieve njerëzore ndodh në komunitetin ose zonën e tyre, krahasuar me 33 për qind të grupmoshës 15–17 vjeç, dhe 28 për qind të grupmoshës 18–24 vjeç.

Figura 5. Njohuri për ndodhshmërinë e trafikimit të shtetasve shqiptarë, sipas grupmoshës



Grafiku paraqet vetëm përqindjet për alternativat e përgjigjeve “në masë shumë të madhe” dhe “në masë të madhe”. **Popullata e synuar:** Romët

### Format e shfrytëzimit të shqiptarëve në Shqipëri dhe jashtë vendit

Në përgjithësi, të rinjtë romë të anketuar kanë më pak njohuri sesa popullsia e përgjithshme e anketuar në të katër qarqet për format e shfrytëzimit që ndodhin në Shqipëri (Tabela 2). Të rinjtë romë të anketuar kanë më shumë njohuri sesa popullsia e përgjithshme e anketuar në të katërta qarqet rreth formave të mëposhtme të shfrytëzimit: martesë e hershme, martesë e detyruar dhe lypje e detyruar e të rriturve. Diferenca më e madhe vihet re te lypja e detyruar e të rriturve, ku 81 për qind e të rinjve romë të anketuar kanë njohuri për këtë formë shfrytëzimi krahasuar me 66 për qind të popullsisë së përgjithshme të anketuar.

**Për sa u përket formave të shfrytëzimit që ndodhin në vende të huaja, të rinjtë romë të anketuar** kanë më shumë njohuri sesa popullsia e përgjithshme e anketuar në të katërta qarqet, sidomos lidhur me martesën e detyruar, martesën e hershme, lypjen e detyruar të të rriturve dhe lypjen e detyruar të fëmijëve.

Tabela.2. Njohuritë për format e shfrytëzimit që ndodhin në Shqipëri dhe jashtë vendit (%)

| Forma e shfrytëzimit                   | Në Shqipëri |                 | Jashtë vendit |                 |
|--|-------------|-----------------|---------------|-----------------|
|  | Romët       | Totali, 4 qarqe | Romët         | Totali, 4 qarqe |
| shfrytëzimi seksual i të rriturve      | 63          | 80              | 61            | 76              |
| shfrytëzimi seksual i fëmijëve         | 70          | 87              | 67            | 73              |
| puna e detyruar e të rriturve          | 68          | 70              | 67            | 67              |
| puna e detyruar e fëmijëve             | 80          | 83              | 76            | 70              |
| martesa e detyruar                     | 78          | 67              | 69            | 56              |
| martesa e hershme                      | 91          | 85              | 82            | 57              |
| lypja e detyruar e të rriturve         | 81          | 66              | 66            | 56              |
| lypja e detyruar e fëmijëve            | 93          | 93              | 85            | 76              |
| kriminaliteti i detyruar i të rriturve | 75          | 81              | 75            | 81              |
| kriminaliteti i detyruar i fëmijëve    | 79          | 83              | 77            | 76              |
| <b>N.</b>                              | <b>200</b>  | <b>1,387</b>    | <b>200</b>    | <b>1,387</b>    |

**Pyetje ankete:** Në dijeninë tuaj, a ndodhin format e mëposhtme të shfrytëzimit, që përfshijnë shtetasit shqiptarë, në Shqipëri dhe në vende të huaja? Tabela tregon përqindjet vetëm për alternativën e përgjigjes “po”. **Popullata e synuar:** Romët; Në total katër qarqe.

### Grupet në risk nga trafikimi i qenieve njerëzore

Rezultatet e anketës tregojnë se ka një perceptim të anshëm gjinor te të rinjtë romë të anketuar për grupet e personave në risk nga trafikimi i qenieve njerëzore (Tabela 3). Grupi i konsideruar nga të rinjtë romë të anketuar si më shumë në risk janë vajzat nën 18 vjeç. Gjashtëdhjetë e gjashtë për qind e të rinjve romë të anketuar e konsiderojnë këtë grup si konsiderueshëm ose në risk të lartë për t’u trafikuar, në krahasim me 77 për qind të popullsisë së përgjithshme të anketuar në të katërta qarqet. Të rinjtë romë mendojnë

se grupi i dytë më në risk për t'u trafikuar janë pakicat kombëtare. Pesëdhjetë e pesë për qind e të rinjve romë të anketuar mendojnë se pakicat kombëtare janë konsiderueshëm ose në risk të lartë për t'u trafikuar, në krahasim me 47 për qind në të katër qarqet. Të rinjtë romë kanë më shumë njohuri për raste të meshkujve 18 vjeç ose më të mëdhenj që janë në risk për t'u trafikuar. Rreth një në pesë (19%) të rinj romë i konsiderojnë meshkujt e kësaj moshe si në risk për t'u trafikuar, në krahasim me vetëm pesë për qind të popullsisë së përgjithshme të anketuar në të katër qarqet.


Tabela.3. Njohuri për grupet e popullsisë në risk për t'u trafikuar (%)

| Grupi i popullatës         | Romët      | Totali, 4 qarqe |
|----------------------------|------------|-----------------|
| gra (18 dhe mbi 18 vjeç)   | 39         | 37              |
| vajza (nën 18 vjeç)        | 66         | 77              |
| burra (18 dhe mbi 18 vjeç) | 19         | 5               |
| djem (nën 18 vjeç)         | 34         | 26              |
| pakicat kombëtare          | 55         | 47              |
| persona nga zona rurale    | 30         | 30              |
| <b>N.</b>                  | <b>200</b> | <b>1,387</b>    |

**Pyetje ankete:** Në dijeninë tuaj, në ç'masë mendoni se secili nga grupet e mëposhtme të popullsisë janë konsiderueshëm ose në risk të lartë për t'u trafikuar? Tabela tregon përqindjet e të anketuarve lidhur me opinionin se grupe specifike janë "konsiderueshëm" ose në risk "të lartë" për t'u trafikuar. **Popullata e synuar:** Romët; Në total katër qarqe.

Ka diferenca në njohuritë e grupeve në risk ndërmjet të rinjve romë të anketuar meshkuj dhe femra (Figura 6), por nuk janë bërë komente bindëse lidhur me diferencat. Më shumë femra sesa meshkuj (përkatësisht 43% dhe 35%) kanë njohuri se vajzat nën 18 vjeç dhe gratë 18 vjeç ose më të mëdha janë në risk për t'u trafikuar. Ndërkohë, më shumë meshkuj sesa femra kanë njohuri se burrat 18 vjeç ose më të mëdhenj janë konsiderueshëm ose në risk të lartë për t'u trafikuar (përkatësisht 22% dhe 15%).


Figura 6. Njohuri për grupet e popullsisë në risk për t'u trafikuar, sipas seksit



Grafiku paraqet përqindjet e të anketuarve lidhur me opinionin se grupe specifike janë "konsiderueshëm" ose në risk "të lartë" për t'u trafikuar. **Popullata e synuar:** Romët

Gjithashtu, ka ndryshime në njohuritë lidhur me ata në risk për t'u trafikuar ndërmjet grupmoshave të ndryshme (Figura 7). Të rinjtë romë të grupmoshës 15–17 vjeç kanë më shumë njohuri sesa grupmoshat e tjera se djemtë nën 18 vjeç janë konsiderueshëm ose në risk më të lartë për t'u trafikuar (41% e grupmoshës 15–17 vjeç, 34% e grupmoshës 18–24 vjeç dhe 24% e grupmoshës 25–29 vjeç).

Figura 7. Njohuri për grupet e popullsisë në risk për t'u trafikuar, sipas grupmoshës



Grafiku paraqet përqindjet e të anketuarve lidhur me opinionin se grupe specifike janë "konsiderueshëm" ose në risk "të lartë" për t'u trafikuar. **Popullata e synuar:** Romët.

## Metodat e rekrutimit dhe trafikantët e qenieve njerëzore

Për të vlerësuar njohuritë e të rinjve romë për metodat e rekrutimit dhe se kush mund të jetë trafikant i qenieve njerëzore, të rinjtë u pyetën nëse binin dakord me disa pohime që lidheshin me metodat. **Në përgjithësi, të rinjtë romë të anketuar kanë më pak njohuri për metodat e rekrutimit dhe për trafikantët e qenieve njerëzore sesa popullsia e anketuar në të katërta qarqet (Tabela 4). Në veçanti, pak prej tyre e dinë se familjarët mund të jenë trafikantë (39% krahasuar me 48% të popullsisë së përgjithshme).**


Tabela .4. Njohuri rreth metodave të rekrutimit dhe rreth trafikantëve të qenieve njerëzore (%)

| Metoda e rekrutimit  | Romët      | Totali, 4 qarqe |
|--|------------|-----------------|
| Trafikantët janë pjesë e rrjeteve të organizuara kriminale         | 78         | 90              |
| Për të rekrutuar viktimë mund të përdoret interneti                | 76         | 94              |
| Trafikantët të qenieve njerëzore mund të jenë miqtë                | 76         | 86              |
| Trafikantët të qenieve njerëzore mund të jenë familjarët           | 39         | 48              |
| Trafikant i qenieve njerëzore mund të jetë i dashuri ose e dashura | 73         | 85              |
| <b>N.</b>  | <b>200</b> | <b>1,387</b>    |

**Pyetje ankete:** Në ç'masë bini ose nuk bini dakord me pohimet e mëposhtme? Tabela tregon përqindjet e të anketuarve që bien plotësisht dakord ose disi dakord me pohimet. **Popullata e synuar:** Romët; Në total katër qarqe.

Megjithatë, të rejtat romë kanë më shumë njohuri sesa të rinjtë romë mbi metodat e rekrutimit dhe trafikantët e qenieve njerëzore (Figura 8), edhe pse më shumë meshkuj e dinë se trafikantët e qenieve njerëzore janë pjesë e rrjeteve të organizuara kriminale.


Figura 8. Njohuri rreth metodave të rekrutimit dhe rreth trafikantëve të qenieve njerëzore, sipas seksit



Grafiku tregon përqindjet e të anketuarve që bien plotësisht dakord ose disi dakord me pohimet. **Popullata e synuar:** Romët.

**Të rinjtë romë të anketuar të grupmoshës 25-29 vjeç kanë më shumë njohuri sesa grupmoshat e tjera se kush mund të jetë trafikant i qenieve njerëzore (Figura 9):** vetëm 26 për qind e grupmoshës 15-17 vjeç kanë njohuri të tilla krahasuar me 41 për qind të grupmoshës 18-24 vjeç dhe 49 për qind të grupmoshës 25-29 vjeç.

Figura 9. Njohuri rreth metodave të rekrutimit dhe rreth trafikantëve të qenieve njerëzore, sipas grupmoshës




Grafiku paraqet përqindjet e të anketuarve që bien plotësisht dakord ose disi dakord me pohimet. **Popullata e synuar:** Romët.

## Mënyrat për të raportuar rastet e dyshuara të trafikimit të qenieve njerëzore

**Të rinjtë romë të anketuar kanë më pak njohuri sesa popullsia e përgjithshme e anketuar në të katërta qarqet rreth mënyrave të raportimit të rasteve të dyshuara të trafikimit të qenieve njerëzore (Figura 10), krahas raportimit të këtyre rasteve në polici.**

Figura 10. Njohuri rreth mënyrave për të raportuar rastet e dyshuara të trafikimit të qenieve njerëzore



**Pyetje ankete:** Në ditjenë tuaj, cili nga kanalet e mëposhtme mund të përdoret për të raportuar një rast të dyshuar të trafikimit të qenieve njerëzore? Disa. **Popullata e synuar:** Romët; Në total katër qarqe.

Nuk kishte diferenca të ndjeshme ndërmjet të rinjve romë dhe të rejave rome të anketuara lidhur me njohuritë mbi mënyrat e raportimit të rasteve të dyshuara të trafikimit të qenieve njerëzore, me pak më shumë meshkuj (90%) sesa femra (86%) që e dinë se mund t'i raportojnë këto raste në polici, dhe pak më shumë femra (10%) sesa meshkuj (6%) që e dinë se mund të raportojnë te mësuesit, psikologët dhe profesionistët të tjerë në shkollë (Tabela 5).

Megjithatë, edhe pse ka ndryshime në këto njohuri ndërmjet grupmoshave të të rinjve, nuk mund të nxirren përfundime lidhur me grupmoshën që ka njohuri më të mira. Pak persona të kësaj grupmoshe 15-17 vjeç e dinë se mund t'i raportojnë rastet e dyshuara të trafikimit të qenieve njerëzore te linja telefonike e policisë 129, te organizatat jofitimprurëse dhe te linja të tjera raportimi, në krahasim me grupmoshat e tjera. Vetëm 34 për qind e romëve 15-17 vjeç dinë t'i raportojnë rastet nëpërmjet linjës telefonike 129, krahasuar me 49 për qind të grupmoshës 18-24 vjeç dhe 53 për qind të grupmoshës 25-29 vjeç. Vetëm tetë për qind e personave të grupmoshës 15-17 vjeç e dinë se mund t'i raportojnë rastet te organizata jofitimprurëse, krahasuar me 13 për qind të grupmoshës 18-24 vjeç dhe 20 për qind të grupmoshës 25-29 vjeç.

Tabela 5. Njohuri rreth mënyrave për të raportuar rastet e dyshuara të trafikimit të qenieve njerëzore, sipas seksit dhe grupmoshës (%)


| Ku të raportoni raste të trafikimit                                | Gjinia    |            | Grupmosha (vjeç) |           |           |
|--|-----------|------------|------------------|-----------|-----------|
|  | F         | M          | 15-17            | 18-24     | 25-29     |
| rajoni i policisë  | 86        | 90         | 92               | 87        | 86        |
| linja telefonike e policisë 129                                    | 47        | 44         | 34               | 49        | 53        |
| mësues, psikolog, profesionist tjetër në shkollë                   | 10        | 6          | 11               | 7         | 4         |
| punonjës për mbrojtjen e fëmijës                                   | 3         | 1          | 2                | 2         | 2         |
| organizatë jofitimprurëse  | 16        | 11         | 8                | 13        | 20        |
| mjek, infermier  | 2         | 4          | 7                | 1         | 2         |
| linja kombëtare për këshillimin e fëmijëve (ALO 116)               | 5         | 2          | 3                | 2         | 6         |
| linja telefonike kombëtare (116 006)                               | 7         | 1          | 2                | 0         | 12        |
| aplikacion telefonik ("Telefono, Raporto!")                        | 0         | 0          | 0                | 0         | 0         |
| profesionist tjetër në bashki ose njësinë administrative përkatëse | 12        | 6          | 7                | 10        | 8         |
| asnjëra nga alternativat e mësipërme                               | 10        | 6          | 7                | 9         | 8         |
| tjetër   | 0         | 0          | 0                | 0         | 0         |
| nuk u dha përgjigje  | 0         | 1          | 0                | 1         | 0         |
| <b>N.</b>  | <b>92</b> | <b>108</b> | <b>61</b>        | <b>90</b> | <b>49</b> |

**Popullata e synuar:** Romët.

**Vetëm 21 për qind e të rinjve romë njohin të paktën tri mënyra për raportimin e rasteve të dyshuara të trafikimit të qenieve njerëzore, krahasuar me 49 për qind në popullatën e përgjithshme në katër qarqet (Figura 11).**

Raportimi ballë për ballë tek institucionet ligjzbatuese është mënyra e parapëlqyer e raportimit të rasteve të dyshuara të trafikimit sipas të gjitha grupeve të anketuara (59% e të rinjve romë dhe 72% e popullatës së anketuar në 4 qarqet; Tabela 6). **Ndërkohë, 18 për qind e të rinjve romë nuk parapëlqejnë asnjë nga kanalet e sugjeruara të raportimit, krahasuar me vetëm katër për qind të popullatës së përgjithshme të anketuar në të katërta qarqet.**

Figura 11. Njohuri rreth të paktën tri mënyrave për të raportuar rastet e dyshuara të trafikimit të qenieve njerëzore



**Popullata e synuar:** Romët; Totali, katër qarqe

Tabela 6. Kanalet e parapëlqyera të raportimit të një rasti të dyshuar të trafikimit të qenieve njerëzore (%)


| Mënyrat e raportimit të rastit të trafikimit                       | Rom/e      | Totali, 4 qarqe |
|--|------------|-----------------|
| ballë për ballë tek institucionet ligjzbatuese (polici, prokurori) | 59         | 72              |
| shërbimet telefonike (linjat e këshillimit, linjat e ndihmës)      | 26         | 36              |
| raportimi ballë për ballë tek institucionet joligjzbatuese         | 18         | 24              |
| OJF e specializuar për çështjen                                    | 6          | 12              |
| platformë në internet, aplikacion telefoni                         | 2          | 9               |
| asnjëra nga alternativat e mësipërme                               | 18         | 4               |
| nuk u dha përgjigje  | 2          | 1               |
| <b>N.</b>  | <b>200</b> | <b>1,387</b>    |

**Pyetja e anketës:** Cilin nga kanalet e mëposhtme të raportimit të një rasti të trafikimit të qenieve njerëzore do të merrnit në konsideratë ose do të parapëlqenit të raportoni? Disa. **Popullata e synuar:** Romët; Totali, katër qarqe.

## Shërbimet mbështetëse të disponueshme për viktimat e trafikimit të qenieve njerëzore

Njohuria e të rinjve romë të anketuar lidhur me shërbimet mbështetëse të disponueshme për viktimat e trafikimit të qenieve njerëzore është shumë më e paktë sesa njohuria e popullatës së përgjithshme të anketuar në të katërta qarqet (Figura 12). Për shembull, vetëm shtatë për qind e tyre janë në dijeni për disponueshmërinë e mbështetjes psikosociale, krahasuar me 28 për qind të popullatës së përgjithshme të anketuar. Ndërkohë, 53 për qind e të rinjve romë nuk kanë dijeni për asnjë formë mbështetjeje të disponueshme për viktimat e trafikimit të qenieve njerëzore, krahasuar me 27 për qind të popullatës së përgjithshme.

Figura 12. Njohuri rreth mbështetjes së disponueshme për viktimat e trafikimit të qenieve njerëzore në Shqipëri



**Pyetja e anketës:** Në dijeninë tuaj, cilat nga llojet e mëposhtme të mbështetjes janë të disponueshme për viktimat e trafikimit të qenieve njerëzore në Shqipëri? Disa. **Popullata e synuar:** Romët; Totali, katër qarqe

Ndryshimi më i madh ndërmjet të rinjve romë femra dhe meshkuj, që janë në dijeni të mbështetjes së disponueshme për viktimat e trafikimit të qenieve njerëzore, lidhet me mbështetjen e posaçme të ofruar nga policia e shtetit (19% dhe 35%, përkatësisht; Tabela 7). **Ndërkohë, 56 për qind e meshkujve nuk kanë njohuri rreth asnjë mbështetjeje të tillë, krahasuar me 49 për qind të femrave.**

Gjithashtu, ka dallim edhe në nivelin e njohurive rreth shërbimeve mbështetëse për viktimat ndërmjet grupmoshave, megjithëse këto diferenca janë të vogla. Të rinjtë e moshës 18-24 vjeç kanë nivelin më të ulët të njohurive (18%) për disponueshmërinë e mbështetjes së posaçme nga policia e shtetit në vend, krahasuar me të rinjtë e tjerë romë (31% e 15-17 vjeçarëve dhe 37% e 25-29 vjeçarëve), dhe **vetëm tre për qind e grupmoshave më të reja janë në dijeni të mbështetjes psikologjike të disponueshme, krahasuar me 16 për qind të grupmoshës 25-29 vjeç. Ndërkohë, 64 për qind e romëve të moshës 18-24 vjeç nuk kishin njohuri rreth asnjë lloji mbështetjeje të disponueshme, krahasuar me 43 për qind të 15-17 vjeçarëve dhe 45 për qind të 25-29 vjeçarëve.**


Tabela 7. Njohuri rreth mbështetjes së disponueshme për viktimat e trafikimit të qenieve njerëzore në Shqipëri, sipas seksit dhe grupmoshës (%)

| Lloji i mbështetjes për viktimat  | Gjinia    |            | Grupmosha (vjeç) |           |           |
|---|-----------|------------|------------------|-----------|-----------|
|   | F         | M          | 15-17            | 18-24     | 25-29     |
| mbështetje e posaçme nga policia e shtetit                                | 35        | 19         | 31               | 18        | 37        |
| mbështetje psikosociale (shëndeti mendor)                                 | 8         | 6          | 3                | 3         | 16        |
| mbështetje sociale (përfshirë mbështetjen për riintegrim) nga qeveria     | 8         | 6          | 7                | 4         | 10        |
| mbështetje sociale (përfshirë mbështetjen për riintegrim) nga OJF-të      | 4         | 3          | 0                | 3         | 8         |
| mbështetje për strehim  | 9         | 9          | 13               | 6         | 10        |
| këshillim, mbështetje nëpërmjet linjave telefonike të këshillimit/ndihmës | 3         | 7          | 7                | 4         | 6         |
| akomodim në strehë  | 11        | 15         | 11               | 10        | 20        |
| mbështetje financiare   | 12        | 19         | 20               | 13        | 14        |
| mbështetje për punësim  | 4         | 7          | 8                | 3         | 8         |
| mbështetje mjekësore  | 2         | 3          | 0                | 3         | 4         |
| këshillim për të drejtat ligjore dhe shërbimet e disponueshme             | 7         | 1          | 2                | 3         | 6         |
| mbështetje e posaçme për trajnim ose arsimim                              | 0         | 1          | 0                | 1         | 0         |
| nuk e dinte ose nuk u përgjigj  | 49        | 56         | 43               | 64        | 45        |
| <b>N.</b>   | <b>92</b> | <b>108</b> | <b>61</b>        | <b>90</b> | <b>49</b> |

*Popullata e synuar:* Romët.

**Vetëm 13 për qind e të rinjve romë të anketuar ishin në dijeni për të paktën tri lloje mbështetjeje për viktimat e trafikimit, krahasuar me 39 për qind të popullatës së përgjithshme të anketuar në të katërta qarqet (Figura 13).**

Figura 13. Njohuri rreth të paktën tri formave të mbështetjes së disponueshme për viktimat e trafikimit të qenieve njerëzore në Shqipëri



*Popullata e synuar:* Romët; Totali, katër qarqe.

### 4.3 Qëndrimet lidhur me trafikimin e qenieve njerëzore


#### Nivelet e shqetësimit

**Nivelet e shqetësimit lidhur me trafikimin e qenieve njerëzore janë shumë më të ulëta te të rinjtë romë të anketuar krahasuar me popullatën e përgjithshme të anketuar në të katërta qarqet (55% e të rinjve romë të anketuar janë jashtëzakonisht ose shumë të shqetësuar, krahasuar me**




69% të popullatës së përgjithshme; Figura 14). Të rejtat rome të anketuara janë më të shqetësuara sesa të rinjtë romë për trafikimin e qenieve njerëzore në Shqipëri (përkatësisht, 65% jashtëzakonisht ose shumë të shqetësuara, krahasuar me 45%; Figura 15).

Figura 14. Niveli i shqetësimit lidhur me trafikimin e qenieve njerëzore në Shqipëri



**Pyetja e anketës:** Sa i/e shqetësuar jeni lidhur me trafikimin e qenieve njerëzore në Shqipëri? Grafiku paraqet përqindjen e të anketuarve që ndihen 'jashtëzakonisht' ose 'shumë' të shqetësuar.  
**Popullata e synuar:** Romët; Totali, katër qarqe.


Figura 15. Niveli i shqetësimit lidhur me trafikimin e qenieve njerëzore në Shqipëri, sipas seksit



Grafiku paraqet përqindjen e të anketuarve që ndihen 'jashtëzakonisht' ose 'shumë' të shqetësuar. **Popullata e synuar:** Romët.

**Të rinjtë romë të moshës 25-29 vjeç janë më të shqetësuar për trafikimin e qenieve njerëzore sesa grupmoshat e tjera** (59% jashtëzakonisht ose shumë të shqetësuar, krahasuar me 52% të grupmoshës 15-17 vjeç dhe 53% të grupmoshës 18-24 vjeç; Figura 16).

Figura 16. Niveli i shqetësimit lidhur me trafikimin e qenieve njerëzore në Shqipëri, sipas grupmoshës



Grafiku paraqet përqindjen e të anketuarve që ndihen 'jashtëzakonisht' ose 'shumë' të shqetësuar. **Popullata e synuar:** Romët.

Të rinjtë romë janë më të shqetësuar për mungesën e zbatimit të ligjit (70%), megjithëse femrat më pak sesa meshkujt, dhe për rritjen e trafikimit të fëmijëve dhe të rinjve (56%) (Tabela 8). Vetëm 63 për qind e të rejave rome janë të shqetësuara për mungesën e zbatimit të ligjit, krahasuar me 76 për qind të të rinjve romë meshkuj.

**Të rinjtë romë të moshës 25-29 vjeç janë më të shqetësuar sesa të rinjtë e tjerë lidhur me shumicën e aspekteve të trafikimit të qenieve njerëzore.** Për shembull, 32 për qind e tyre janë të shqetësuar për besueshmërinë e ulët të institucioneve përkatëse, krahasuar me vetëm 13 për qind të grupmoshës 15-17 vjeç dhe 20 për qind të grupmoshës 18-24 vjeç.

Tabela 8. Fushat më kryesore të shqetësimit lidhur me trafikimin e qenieve njerëzore, sipas seksit dhe grupmoshës (%)


| Fusha e shqetësimit   | Totali     |              | Rom/e     |            |                  |           |           |
|---|------------|--------------|-----------|------------|------------------|-----------|-----------|
|   | Rom/e      | 4 qarqe      | Gjinia    |            | Grupmosha (vjeç) |           |           |
|   |            |              | F         | M          | 15-17            | 18-24     | 25-29     |
| mungesa e zbatimit të ligjit  | 70         | 72           | 63        | 76         | 62               | 73        | 73        |
| rritja e trafikimit të fëmijëve ose të rinjve                                 | 56         | 63           | 59        | 54         | 60               | 53        | 59        |
| rritja e trafikimit të të rriturve  | 17         | 28           | 16        | 17         | 13               | 16        | 22        |
| besueshmëria e ulët e institucioneve përkatëse ku raportohen raste të tilla   | 21         | 41           | 18        | 24         | 13               | 20        | 32        |
| niveli i ulët i ndërgjegjësimit të popullatës lidhur me këtë fenomen          | 18         | 47           | 20        | 17         | 11               | 23        | 20        |
| mbështetja e pamjaftueshme për viktimat                                       | 13         | 34           | 15        | 12         | 2                | 16        | 22        |
| lidhja ndërmjet krimit të organizuar dhe trafikimit të qenieve njerëzore      | 4          | 28           | 3         | 5          | 0                | 3         | 10        |
| lidhja ndërmjet migracionit të paligjshëm dhe trafikimit të qenieve njerëzore | 4          | 17           | 1         | 6          | 0                | 4         | 7         |
| <b>N.</b>   | <b>200</b> | <b>1,387</b> | <b>92</b> | <b>108</b> | <b>61</b>        | <b>90</b> | <b>49</b> |

**Pyetja e anketës:** Çfarë ju shqetëson më shumë? Disa. **Popullata e synuar:** Romët; Totali, katër qarqe.

## Qëndrimet ndaj viktimave

Të rinjtë romë janë më pak mbështetës ndaj ofrimit të mbështetjes për viktimat e trafikimit sesa popullata e përgjithshme (69% dhe 90%, përkatësisht; Figura 17).

Figura 17. Niveli i dakordimit me ofrimin e mbështetjes për viktimat e trafikimit dhe personat në risk për t'u trafikuar



**Pyetja e anketës:** Sa mbështetës/e jeni ndaj ofrimit të mbështetjes së veçantë për viktimat e trafikimit ose personat në risk për t'u trafikuar? **Popullata e synuar:** Romët; Totali, katër qarqe.

Nuk ekziston ndryshim i konsiderueshëm ndërmjet të rinjve romë femra dhe meshkuj të anketuar sa i përket nivelit të dakordimit së tyre me ofrimin e mbështetjes për viktimat e trafikimit të qenieve njerëzore (Tabela 9). **Të rinjtë romë të moshës 25-29 vjeç shfaqin më tepër empati sesa të rinjtë e tjerë ndaj viktimave** (80% krahasuar me 70% të grupmoshës 15-17 vjeç dhe 62% të grupmoshës 18-24 vjeç).

Tabela 9. Niveli i dakordimit me ofrimin e mbështetjes për viktimat e trafikimit dhe personat në risk për t'u trafikuar, sipas seksit dhe grupmoshës (%)

| Niveli i dakordimit      | Gjinia    |            | Grupmosha (vjeç) |           |           |
|--------------------------|-----------|------------|------------------|-----------|-----------|
|                          | F         | M          | 15-17            | 18-24     | 25-29     |
| jastëzakonisht ose shumë | 70        | 69         | 70               | 62        | 80        |
| disi                     | 21        | 15         | 20               | 19        | 12        |
| pak ose aspak            | 7         | 9          | 7                | 11        | 4         |
| nd ose np                | 3         | 7          | 3                | 8         | 4         |
| <b>N</b>                 | <b>92</b> | <b>108</b> | <b>61</b>        | <b>90</b> | <b>49</b> |


**Popullata e synuar:** Romët. nd - nuk e di; np - nuk u përgjigj.

## 4.4 Praktikrat lidhur me trafikimin e qenieve njerëzore

### Interesi për të mësuar rreth trafikimit të qenieve njerëzore

Të rinjtë romë kanë interes shumë më të ulët për të mësuar rreth trafikimit të qenieve njerëzore sesa popullata e përgjithshme në të katërta qarqet (Figura 18). Ndryshimi është më i theksuar sa i përket të mësuarit rreth institucioneve ku viktimat e trafikimit të qenieve njerëzore mund të drejtohen për të marrë ndihmë ose mbështetje (25% dhe 43% përkatësisht) dhe që është tema më me interes për të rinjtë romë.


Figura 18. Niveli i interesit për të mësuar rreth trafikimit të qenieve njerëzore



**Pyetja e anketës:** Deri në cilën masë jeni i/e interesuar për të mësuar rreth këtyre temave? Grafiku paraqet përqindjen e të anketuarve që janë shumë të interesuar. **Popullata e synuar:** Romët; Totali, katër qarqe.

**Të rejtat romë janë më të interesuara sesa të rinjtë meshkuj për të mësuar rreth trafikimit të qenieve njerëzore** (Figura 19). Ndërkohë që 29 për qind e femrave janë shumë të interesuara për të mësuar rreth institucioneve ku viktimat mund të drejtohen për të marrë ndihmë ose mbështetje, vetëm 20 për qind e meshkujve ishin po aq të interesuar.

Figura 19. Niveli i interesit për të mësuar rreth trafikimit të qenieve njerëzore, sipas seksit



Grafiku paraqet përqindjen e të anketuarve që janë shumë të interesuar. **Popullata e synuar:** Romët.

**Të rinjtë romë të moshës 25-29 vjeç janë më të interesuar për të mësuar rreth trafikimit të qenieve njerëzore sesa grupmoshat e tjera** (Tabela 10), veçanërisht sa i përket të mësuarit se kush mund të jetë trafikant ose për profilin e trafikantëve (35% krahasuar me 13% të grupmoshës 15-17 vjeç dhe 24% të grupmoshës 18-24 vjeç).

Tabela 10. Niveli i interesit për të mësuar rreth trafikimit të qenieve njerëzore, sipas grupmoshës (%)

| Çështje e trafikimit të qenieve njerëzore  | Grupmosha (vjeç) |       |       |
|--|------------------|-------|-------|
|  | 15-17            | 18-24 | 25-29 |
| Kush është në risk për t'u trafikuar   | 15               | 23    | 27    |
| Format e ndryshme të shfrytëzimit  | 15               | 22    | 31    |
| Kush mund të jetë trafikant ose profili i trafikantëve   | 13               | 24    | 35    |
| Metodat ose taktikat e rekrutimit të viktimave   | 18               | 19    | 31    |
| Mënyrat për të raportuar rastet e dyshuara të trafikimit të qenieve njerëzore                      | 16               | 23    | 33    |
| Ku mund të drejtohen viktimat e trafikimit të qenieve njerëzore për të marrë ndihmë ose mbështetje | 18               | 24    | 33    |
| N.   | 61               | 90    | 49    |

Tabela paraqet përqindjen e të anketuarve që janë shumë të interesuar. **Popullata e synuar:** Romët.

### Interesi për t'u përfshirë në parandalimin dhe mbrojtjen nga trafikimi i qenieve njerëzore

Të rinjtë romë janë shumë më pak të interesuar për t'u përfshirë në aktivitetet e parandalimit dhe mbrojtjes nga trafikimi i qenieve njerëzore sesa popullata e përgjithshme në të katërta qarqet (Tabela 11). Kjo është më e theksuar sa u përket niveleve të interesit për ofrimin e ndihmës ose mbështetjes ndaj viktimave ose viktimave të mundshme të trafikimit (34% dhe 59%, përkatësisht). Të rinjtë romë janë më të interesuar për të raportuar diku lidhur me një rast të mundshëm trafikimi të qenieve njerëzore (39%) dhe më pak të interesuar për të mbështetur aktivitetet e mbledhjes së fondeve për programet kundër trafikimit (21%).


Tabela 11. Niveli i interesit për t'u përfshirë në aktivitetet e parandalimit dhe mbrojtjes nga trafikimi i qenieve njerëzore (%)

| Aktiviteti i parandalimit dhe mbrojtjes kundër trafikimit të qenieve njerëzore      | Rom/e | Totali, 4 qarqe |
|---|-------|-----------------|
| Ofrimi i ndihmës ose mbështetjes për viktimat ose viktimat e mundshme të trafikimit | 34    | 59              |
| Përfshirja në bisedime ose aktivitete kundër trafikimit në shkollë ose komunitet    | 31    | 55              |
| Informimi i familjarëve ose miqve për çështjet e trafikimit të qenieve njerëzore    | 37    | 61              |
| Vullnetarizmi në punën kundër trafikimit të një OJF-je                              | 23    | 39              |
| Mbështetja e mbledhjes së fondeve për programet kundër trafikimit                   | 21    | 40              |
| Raportimi për një viktimitë të mundshme të trafikimit të qenieve njerëzore          | 39    | 59              |
| Raportimi për një trafikant të dyshuar të qenieve njerëzore                         | 37    | 57              |
| N.  | 200   | 1,387           |

**Pyetja e anketës:** Sa i/e interesuar do të ishit të përfshiheshit në aktivitetet e mëposhtme? Tabela paraqet përqindjen e të anketuarve që janë shumë ose disi të interesuar. **Popullata e synuar:** Romët; Totali, katër qarqe.

Të rejtat rome janë më të interesuara për t'u përfshirë në aktivitetet e parandalimit dhe mbrojtjes nga trafikimi sesa të rinjtë romë (Figura 20), me përjashtim të vullnetarizmit në punën e një OJF-je kundër trafikimit dhe mbështetjes së mbledhjes së fondeve për programet kundër trafikimit. Për shembull, 40 për qind e të rejave rome janë shumë ose disi të interesuara për të informuar familjarët ose miqtë e tyre rreth trafikimit të qenieve njerëzore krahasuar me 34 për qind të meshkujve.

Figura 20. Niveli i interesit për t'u përfshirë në aktivitetet e parandalimit dhe mbrojtjes nga trafikimi i qenieve njerëzore, sipas seksit



Grafiku paraqet përqindjen e të anketuarve që janë shumë ose disi të interesuar. **Popullata e synuar:** Romët.

Të rinjtë romë të moshës 15-17 vjeç janë më pak të interesuar për t'u përfshirë në aktivitetet e parandalimit të trafikimit të qenieve njerëzore dhe mbrojtjes së viktimave sesa grupmoshat e tjera (Tabela 12). Për shembull, vetëm 26 për qind e këtyre të rinjve romë janë shumë ose disi të interesuar për të informuar familjarët ose miqtë e tyre rreth çështjeve të trafikimit të qenieve njerëzore krahasuar me 43 për qind të grupmoshës 18-24 vjeç dhe 39 për qind të grupmoshës 25-29 vjeç.

Tabela 12. Niveli i interesit për t'u përfshirë në aktivitetet e parandalimit dhe mbrojtjes nga trafikimi i qenieve njerëzore, sipas grupmoshës (%)

| Aktiviteti i parandalimit dhe mbrojtjes kundër trafikimit të qenieve njerëzore      | Grupmosha (vjeç) |           |           |
|---|------------------|-----------|-----------|
|   | 15-17            | 18-24     | 25-29     |
| Ofrimi i ndihmës ose mbështetjes për viktimat ose viktimat e mundshme të trafikimit | 28               | 37        | 37        |
| Përfshirja në bisedime ose aktivitete kundër trafikimit në shkollë ose komunitet    | 23               | 34        | 35        |
| Informimi i familjarëve ose miqve për çështjet e trafikimit të qenieve njerëzore    | 26               | 43        | 39        |
| Vullnetarizmi në punën kundër trafikimit të një OJF-je                              | 20               | 24        | 24        |
| Mbështetja e mbledhjes së fondeve për programet kundër trafikimit                   | 20               | 21        | 20        |
| Raportimi për një viktimë të mundshme të trafikimit të qenieve njerëzore            | 34               | 39        | 43        |
| Raportimi për një trafikant të dyshuar të qenieve njerëzore                         | 34               | 38        | 39        |
| <b>N.</b>   | <b>61</b>        | <b>90</b> | <b>49</b> |


Tabela paraqet përqindjen e të anketuarve që janë shumë ose disi të interesuar. **Popullata e synuar:** Romët.

#### 4.5 Rezultatet e strategjisë së komunikimit të UNICEF-it

Thuajse 26 për qind (N=53) e të rinjve romë të anketuar raportojnë se janë ekspozuar ndaj materialeve rreth trafikimit të qenieve njerëzore gjatë dy viteve të fundit.<sup>7</sup> Ekspozimi ndaj materialeve (Figura 21) ishte kryesisht nëpërmjet televizionit (85%), Instagram-it (30%), Facebook-ut (28%), YouTube-it (23%), Tik Tok-ut (19%) dhe diskutimeve në shkollë (17%).

<sup>7</sup> Referuar punimit të realizuar nga UNICEF-i në Shqipëri dhe partnerët e tij, në kuadër të Programit të Financuar nga Mbretëria e Bashkuar 'Transformimi i Përgjigjes Kombëtare ndaj Trafikimit të Qenieve Njerëzore në dhe nga Shqipëria'.

Figura 21. Kanalet e ekspozimit ndaj materialeve të komunikimit mbi trafikimin e qenieve njerëzore



**Pyetja e anketës:** Nëpërmjet cilit kanal komunikimi të mëposhtëm u informuat për ngjarjet, mesazhet ose materialet e komunikimit lidhur me trafikimin e qenieve njerëzore? **Disa.** **Popullata e synuar:** Të rinjtë romë të anketuar, që janë ekspozuar gjatë dy viteve të fundit ndaj ngjarjeve, mesazheve ose materialeve të komunikimit lidhur me trafikimin e qenieve njerëzore.

Thuajse të gjithë të rinjtë romë (94%) që janë ekspozuar ndaj materialeve lidhur me trafikimin e qenieve njerëzore gjatë dy viteve të fundit **raportuan se njohuritë e tyre rreth këtij fenomeni janë zgjeruar si rezultat i ekspozimit** (47% secili në nivel të lartë ose disi; Figura 22).


Figura 22. Masa e përmirësimit të njohurive për trafikimin e qenieve njerëzore pas ekspozimit ndaj materialeve të komunikimit



**Pyetja e anketës:** Deri në ç'masë është përmirësuar niveli juaj i njohurive rreth trafikimit të qenieve njerëzore si rezultat i ekspozimit ndaj ngjarjeve, mesazheve ose materialeve të komunikimit? **Popullata e synuar:** Të rinjtë romë të anketuar, që janë ekspozuar gjatë dy viteve të fundit ndaj ngjarjeve, mesazheve ose materialeve të komunikimit lidhur me trafikimin e qenieve njerëzore.

**Së fundi, 81 për qind e të rinjve të ekspozuar ndaj materialeve për trafikimin e qenieve njerëzore deklaruan se qëndrimet e tyre ndaj trafikimit të qenieve njerëzore kanë ndryshuar (Figura 23), dhe se tani janë të interesuar të luajnë një rol më aktiv në luftën kundër trafikimit të qenieve njerëzore (32% në nivel të lartë; 49% disi). Pavarësisht kësaj, 17 për qind e të rinjve romë të anketuar raportuan se ekspozimi ndaj materialeve për trafikimin e qenieve njerëzore nuk pati asnjë ndikim në qëndrimet e tyre ndaj trafikimit të qenieve njerëzore.**

Figura 23. Masa e ndryshimit të qëndrimeve pas ekspozimit ndaj materialeve rreth trafikimit të qenieve njerëzore



**Pyetja e anketës:** Deri në ç'masë ka ndryshuar qëndrimi juaj lidhur me përfshirjen më aktive në luftën kundër trafikimit të qenieve njerëzore si rezultat i ekspozimit ndaj ngjarjeve, mesazheve ose materialeve të komunikimit? **Popullata e synuar:** Të rinjtë romë të anketuar, që janë ekspozuar gjatë dy viteve të fundit ndaj ngjarjeve, mesazheve ose materialeve të komunikimit lidhur me trafikimin e qenieve njerëzore.

## 5. PËRFUNDIME

Ky raport paraqet gjetjet kryesore nga anketa e valës së dytë dhe mundëson pikëpamje të vlefshme rreth njohurive, qëndrimeve dhe praktikave të të rinjve romë sa i përket trafikimit të qenieve njerëzore. Këto gjetje do t'u shërbejnë subjekteve të përfshira në aktivitetet kundër trafikimit në fushat e parandalimit të trafikimit të qenieve njerëzore dhe mbrojtjes së viktimave.

Analiza tregon se shumica e të rinjve romë janë në dijeni për trafikimin e shtetasve shqiptarë drejt vendeve të huaja, megjithëse një pjesë më e vogël prej tyre janë në dijeni se trafikimi kryhet edhe brenda Shqipërisë, dhe shumë më pak prej tyre janë në dijeni se ai ndodh edhe në komunitetin ose zonën e tyre lokale. Në grupin e të rinjve romë të anketuar, femrat dhe grupmosha 25-29 vjeç kanë më tepër njohuri se ku ndodh trafikimi, krahasuar me meshkujt dhe grupmoshat e tjera. Megjithatë, shumë më pak të rinj romë sesa popullata e përgjithshme e anketuar në katër qarqet njohin format e ndryshme të shfrytëzimit që ndodhin në Shqipëri, megjithëse më shumë prej tyre sesa popullata e përgjithshme kishin njohuri rreth martesës në moshë të hershme, martesës së detyruar dhe lypjes së detyruar të të rriturve. Shumica e të rinjve romë e dinin se vajzat nën moshën 18 vjeç dhe pakicat kombëtare janë në risk për t'u trafikuar, megjithëse më pak prej tyre e dinin se burrat e moshës 18 vjeç e lart janë në risk për t'u trafikuar.

Megjithatë, niveli i njohurive të tyre rreth trafikimit të meshkujve të rritur është shumë më i lartë sesa i popullatës së përgjithshme të anketuar në të katërt qarqet. Më shumë të reja sesa të rinj romë e dinin se vajzat nën moshën 18 vjeç dhe gratë e moshës 18 vjeç e lart janë në risk për t'u trafikuar; megjithëse më shumë meshkuj sesa femra e dinin se burrat e moshës 18 vjeç e lart janë në risk për t'u trafikuar. Ndërkohë, më shumë të rinj të grupmoshës 15-17 vjeç sesa të rinjtë e tjerë dinin se djemtë nën moshën 18 vjeç janë në risk të lartë ose shumë të lartë për t'u trafikuar. Të rinjtë romë kanë njohuri rreth metodave të rekrutimit për trafikim të qenieve njerëzore, dhe rreth trafikantëve të qenieve njerëzore. Megjithatë, pak e dinin se trafikantë të qenieve njerëzore mund të jenë edhe familjarët.

Në grupin e të rinjve romë të anketuar, femrat dhe grupmosha 25-29 vjeç kanë më tepër njohuri sesa meshkujt dhe grupmoshat e tjera rreth metodave të rekrutimit për trafikimin e qenieve njerëzore dhe trafikantëve të qenieve njerëzore. Krahasuar me popullatën e përgjithshme të anketuar në katër qarqet, të rinjtë romë ishin më pak të njohur me mënyrat e raportimit të rasteve të dyshuara të trafikimit (vetëm 21% njohin të paktën 3 mënyra raportimi, krahasuar me 49% të popullatës së përgjithshme). Gjithashtu, ata kanë më pak njohuri rreth shërbimeve mbështetëse të disponueshme për viktimat e trafikimit të qenieve njerëzore, ku më shumë se gjysma nuk ishin në dijeni të asnjë mbështetjeje të tillë.

Shqetësimi për trafikimin e qenieve njerëzore është më i ulët te të rinjtë romë të anketuar sesa në popullatën e përgjithshme të anketuar në katër qarqet, por është më i lartë te të rejtat romë dhe te grupmosha 25-29 vjeç. Qëndrimet e të rinjve romë ndaj viktimave janë pozitive, ku 69 për qind raportojnë se viktimat duhet të marrin mbështetje, veçanërisht të rinjtë e moshës 25-29 vjeç, të cilët kanë më tepër empati ndaj viktimave. Të rinjtë romë kanë më pak interes të mësojnë rreth trafikimit të qenieve njerëzore sesa popullata e përgjithshme, megjithëse ata janë më të interesuar të mësojnë se ku viktimat mund të drejtohen për të marrë ndihmë ose mbështetje. Interesi i të rinjve romë për të mësuar rreth trafikimit të qenieve njerëzore është më i lartë te femrat dhe te grupmosha 25-29 vjeç.

Gjithashtu, të rinjtë romë janë më pak të interesuar sesa popullata e përgjithshme për t'u përfshirë në aktivitetet e parandalimit dhe mbrojtjes nga trafikimi i qenieve njerëzore, ku femrat dhe të rinjtë e moshës 18-29 vjeç janë më të interesuarit.

Pak të rinj romë të anketuar (53/200 ose 26%) raportuan se ishin ekspozuar ndaj materialeve të komunikimit rreth trafikimit të qenieve njerëzore gjatë dy viteve të kaluara. Megjithatë, 94 për qind e atyre që raportuan se ishin ekspozuar raportuan edhe njohuri më të shumta rreth trafikimit të qenieve njerëzore. Vlen të përmendet se 81 për qind e të rinjve të ekspozuar ndaj materialeve të komunikimit raportuan qëndrime më të mira lidhur me trafikimin e qenieve njerëzore dhe interes më të lartë për të luajtur një rol më aktiv në luftimin e këtij fenomeni.

Rezultatet e mësipërme tregojnë se subjektet e përfshira në luftën kundër trafikimit duhet t'i përqendrojnë përpjekjet e tyre te përmirësimi i njohurive, qëndrimeve dhe praktikave lidhur me trafikimin e qenieve

njerëzore të të gjithë të rinjtë romë, me fokus të veçantë të meshkujt dhe të rinjtë romë në moshë më të vogël. Duhet t'i kushtohet vëmendje përmirësimit të njohurive të të rinjve romë lidhur me: praninë e trafikimit të qenieve njerëzore në Shqipëri dhe në komunitetin vendas; format e ndryshme të shfrytëzimit që ndodhin në vend dhe jashtë tij; faktin se djemtë dhe personat në zona rurale janë në risk për t'u trafikuar; se pjesëtarët e familjes mund të jenë trafikantë të qenieve njerëzore; mënyrat e raportimit të rasteve të dyshuara të trafikimit të qenieve njerëzore të subjekte të tjera veç policisë; dhe shërbimet mbështetëse të disponueshme për viktimat e trafikimit të qenieve njerëzore. Programet e parandalimit mund të synojnë edhe përmirësimin e qëndrimeve të të rinjve romë lidhur me trafikimin e qenieve njerëzore. Programet e ardhshme të edukimit mund të shfrytëzojnë metoda komunikimi që janë popullore të të rinjtë romë të anketuar, konkretisht televizionin, mediat sociale, diskutimet në shkollë dhe materialet e shtypura.

